

**AKT THEMELIMI
(KONTRATË)**

**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ZEBI-TRAVEL-Sh.p.k.**

Unë , **Kastriot ZEBI**, i biri i i biri i Femiut, lindur me **31.12.1979** në Peshkopi/Dibër, banues në Nj.Adm.Peshkopi/**Bashkia/Dibër Lagjja "Nazmi Rushiti", Rruga "Haki Sharofi-00320020", Nd.4; H.2; Ap.15; Kodi Postar Nr.8301/Peshkopi**, zotërues i Kartës së Identitetit **nr.personal/personal no. H91231129A**, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

Sot me datë **20.01.2021**

V E N D O S A

Neni 1

Të themeloj një Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar për të ushtruar veprimtari ekonomike të EMËRTUAR : **ZEBI-TRAVEL-Sh.p.k.**

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së derdhur në kapitalin themeltar.

Neni 3

Shoqëria e ka SELINË në Njësinë Administrative të qytetit PESHKOPI, Bashkia/Dibër në adresën : **Lagjja "Gjok Doçi"; Rruga "Tercilio Kardinali-00320061"; Nd.14; H.1; Kodi Postar Nr.8301/Peshkopi.**

Ajo ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë teritorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjensi, përfaqësi, seli sekondare dhe t'i suprimojë ato.

Neni 4

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me një kufi të pacaktuar, **mbi 15 vjet.**

Neni 5

Kapitali Themelor i Shoqërisë do të jetë **1000 Lek (Njëmijë lek).**

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë, **Kastriot ZEBI.**

Ortaku i Vetëm **Kastriot ZEBI**, zotëron **100 %** të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga **1 pjesë e vetme (Një kuotë)** me vlerë nominale prej **1000 Lek (Njëmijë lek).**

Neni 6

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga Ortaku i Vetëm.Rritja e kapitalit nuk është e kufizuar.


Neni 7

Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

Neni 8

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

Veprimtari e agjentit për transfertë parash në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jo bankë.Veprime, këmbime e transaksione financiare. Veprimtari e agjentit për



shërbimin e pagesave në emër dhe për llogari të nje subjekti financiar jo bankar.Veprimtari e agjentit komisioner.Këmbim valuator(Exchange).Transporti i udhëtarëve brenda dhe jashtë vendit.Shërbimi i transportit me taksi.Transporti i mallrave brenda dhe jashtë vendit.

Neni 9

Marëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Ligjit Nr.7961 Dt.12.07.1995”Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”,si dhe akteve të tjera nënligjore të dalta në zbatim të tij.

Neni 10

Ortaku i Vetëm i shoqërisë nuk kufizohet në rritjen e kapitalit të shoqërisë.

Neni 11

Shoqëria vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj.Ortaku i Vetëm Themelues mbart rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në shoqëri.

Neni 12

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të shoqërisë, midis punonjësve brenda saj dhe me të tretët, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, atëherë ato zgjidhen me rrugë gjyqësore në gjykatën kompetente.

Neni 13

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërimit të shoqërisë.

Neni 14

Pasuria e shoqërisë mund të sigurohet pranë shoqërive të sigurimit duke respektuar ligjet që veprojnë në fushën e sigurimit dhe risigurimit.

Neni 15

Organet e Shoqërisë ZEBI-TRAVEL-Sh.p.k.

- Asambleja e Ortakë/ortaku i vetëm
- Administratori/ët e Shoqërisë

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.

Administrator i shoqërisë do të jenë **Z. Kastriot ZEBI**.

Modalitetet për ndryshimin e Administratorit/ve si dhe kompetencat rregullohen nga **Statuti i Shoqërisë dhe Ligji Nr 9901 Dt.14.04.2008”Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”**.

Ky Akt Themelimi është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin dhe është nënshkruar me vetëdije dhe vullnet të plotë prej meje personalisht.

THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE“

ZEBI-TRAVEL - Sh.p.k.

Kastriot ZEBI

KASTRIOT ZEBI

Peshkopi, me 20 Janar 2021